



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Edmond Braha** me datë **20.08.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Verifikimin e nevojave të sigurimit dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” caktuar me vendimin nr.37, datë 10.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me masën e sigurimit personal “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, bazuar në nenin 246/6 e vijues të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **498**, datë **20.09.2024**, vendosi:

1. Shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim, në lidhje me hetimet e kryera, gjendjen e procedimit penal dhe nevojat e sigurimit. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg” për kërkuesin **Edmond Braha**, të caktuar me vendimin me nr.37, datë 10.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, ose një masë tjetër më të butë, si një kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova.
3. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5 (pesë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë **20.09.2024**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar